



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1006/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit DPZ “Servis Toverlani”, me NUI: 810893372, me seli në Llapnasellë pn., në Graçanicë, kundër debitorit “Ledo” SH.P.K., me NUI: 810385668, me seli në Milloshevë, në Obiliq, përfaqësuar sipas autorizimit nga N.S., avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.639/23 të datës 19.05.2023, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Ledo” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.639/23 i datës 19.05.2023, i Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.639/23 i datës 19.05.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit DPZ “Servis Toverlani”, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.639/23 të datës 19.05.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 21-SHV01-001-1600 të datës 14.12.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-1599 të datës 14.12.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-1593 të datës 14.12.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-1592 të datës 14.12.2021; Faturës Nr. 21 - SHV01-001-1589 të datës 13.12.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-1588 të datës 13.12.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-996 të datës 29.07.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-995 të datës 29.07.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-994 të datës 29.07.2021; Faturës Nr. 21-SHV01-001-993 të datës 29.07.2021 dhe Faturës Nr. 21-SHV01-001-992 të datës

29.07.2021; me të cilën është detyruar debitori që në emër të borxhit të mbetur sipas faturave të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën e borxhit të mbetur prej 2,978.95€, me kamat ligjore 8%, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, me realizimin e përbarimit përmes bllokimit të gjitha llogarive bankare të debitorit në të gjitha bankat komerciale të Kosovës, si dhe me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në realizimin e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të autorizuar, e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor duke theksuar se lejimi i propozimit për përbarim në bazë të faturave është i palejueshëm pasi që nuk janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 37 par.1 i LPP-së, ashtu që të njëjtat nuk janë bashkëngjitur në origjinal, apo në kopje të vërtetuara. Tutje ka theksuar se faturat e bashkëngjitura në urdhrin për përbarim nuk plotësojnë as kushtet nga neni 29 par.3 i LPP-së dhe janë të parregullta, si dhe nuk kanë tipare të përbarueshmërisë. Gjykatës i ka propozuar që të aprovet prapësimi i debitorit si i bazuar, te anulohet urdhri përbarimor si dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore dhe atë të prapësimit.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po*

*qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.*

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 21-SHV01-001-1600 të datës 14.12.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-1599 të datës 14.12.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-1593 të datës 14.12.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-1592 të datës 14.12.2021; Faturën Nr. 21 - SHV01-001-1589 të datës 13.12.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-1588 të datës 13.12.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-996 të datës 29.07.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-995 të datës 29.07.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-994 të datës 29.07.2021; Faturën Nr. 21-SHV01-001-993 të datës 29.07.2021 dhe Faturën Nr. 21-SHV01-001-992 të datës 29.07.2021; i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, mbajnë nënshkrimin si dhe vulën origjinale të debitorit.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1006/23, datë 30.10.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.